

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

“Për një ndryshim në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin e Veprimit 2021-2022””

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin e Veprimit 2021-2022””.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- Propozimi i këtij projektvendimi ka si qëllim ndryshimin e Vendimit nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe Planin e Veprimit 2021–2022”, të ndryshuar, si një instrument për të mbledhur të gjithë aktorët e interesuar shtetërorë dhe joshetërorë, si edhe partnerët ndërkombëtarë, në një dakordësi mbi situatën e trafikimit të personave, sfidat e hasura dhe mënyrat e mjetet për t’i përballuar ato.
- Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025 është dokumenti më i rëndësishëm politik kombëtar i cili koordinon aktorët shtetërorë, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile në përpjekjet e përbashkëta për të luftuar trafikimin e personave.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektvendimit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë nga data 31 janar 2024 deri më 20 shkurt 2024.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>:
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Znj. Katerina Gjorgo - Specialiste, Drejtorja e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin, e-mail: Katerina.Gjorgo@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Drejtorja e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin, gjatë muajit shtator zhvilloi takime me anëtarët e Komiteteve Rajonale Antitrafik në disa qarqe, ku u diskutua mbi zbatimin e PKV për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023 si dhe problematikat e adresuara nga pjesëmarrësit shërbyen si udhërrefyes gjatë hartimit të planit të ri kombëtar të veprimit 2024-2025.

- Më datë 26 shtator 2023, u zhvillua takimi në Korçë, ku morrën pjesë përfaqësues nga Bashkia Korçë, Bashkia Maliq, DRSHSSH, NjMF, Fondacioni Kennedy, Misioni Emanuel

- Më datë 11 tetor 2023, u zhvillua takimi në Kukës, ku morrën pjesë përfaqësues nga Bashkia Kukës, Njësitë administrative Bicaj/Surraj/Topojan/Terthore/Shtiqen/Kolis/Malzi, DRSHSSH

- Më datë 12 tetor 2023, u zhvillua takim në Dibër, ku morrën pjesë përfaqësues nga AKPA, Spitali Rajonal DIBër, Bashkia DIBër, Njësitë Administrative Kastriot/Maqellarë/Melan, DRSHSSH, Institucioni i Prefektit, NJVKSH dhe Nisma Arsis

- Më datë 24 tetor 2023, u zhvillua takimi në Vlorë, ku morrën pjesë përfaqësues nga Bashkia Vlorë, DVP, DRSHSSH, SPitali Rajonal Vlorë, DRAKPA, NJVKSH, Këshilli I Qarkut, Prefektura, ZVAP Vlorë-Himarë dhe Qendra Psiko-Sociale Vatra.

- Më datë 30 tetor, u zhvillua takimi në Shkodër, ku morrën pjesë përfaqësues nga Bashkia Shkodër, Prefektura, Bashkia Vau i Dejës, AKPA, Bashkia Malësi e MADhe, ZVA, DRSHSSH, Malteser Albania.

- Gjithashtu, më datë 26 tetor 2023, Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin, organizoi takimin e anëtarëve të MKR-së, ku u prezantua drafti i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025.

Sfondi i propozimit legjislativ

Ky dokument është vazhdim i objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023, por të përshtatura me dinamikën e trafikimit, vizionin e ri qeverisës në qasjen ndaj fenomenit të trafikimit për të krijuar një platformë të mirëorientuar synimesh e objektivash strategjike në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare, si dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

Plani bazohet edhe në raportin e monitorimit të tij për të krijuar vijueshmëri dhe reflektuar në mënyrë adekuate masat e përcaktuara dhe ato të realizuara pjesërisht si edhe për të përfshirë dhe përpunuar masa të cilat janë raportuar të realizuara por që konsistojnë në objektiva e veprimtari të cilat janë aktuale në çdo kohë, të tilla si ndërgjegjësimi, ngritja e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë, bashkërendimi i ndërhyrjeve dhe financimi i tyre i përshtatshëm.

Përgjatë gjithë dokumentit strategjik përçohet vizioni se, trafikimi i personave mund të parandalohet me sukses vetëm nëpërmjet fuqizimit social dhe ekonomik të grupeve dhe personave në nevojë, zbatimit efikas të ligjit dhe ndëshkimit të shkelësve, si dhe fuqizimit të shërbimeve dhe kapaciteteve në ndihmë të personave të trafikuar, qofshin këta viktimat apo viktimat të mundshme të trafikimit. Gjithashtu, ngritja e mekanizmave bashkërendues duke filluar nga niveli bazë do të mundësonte qëllimin përfundimtar të çdo nisme antitrafik, që është identifikimi i çdo viktime trafikimi për t'i dhënë ndihmën, mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme për një riintegrim afatgjatë në shoqëri.

Propozimet

Ministria e Brendshme, vlerëson të domosdoshme miratimin e Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025, për faktin se trafikimi i personave:

- është një fenomen kompleks, që shkon përtej luftës kundër krimit të organizuar dhe lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtave të njeriut;
- është një fenomen që kërkon një qasje të fokusuar, gjithëpërfshirëse, më të gjerë se forcimi i aspekteve të hetimit dhe ndjekjes penale;
- kërkon garanci parandaluese dhe partneritet, mbrojtje dhe asistencë për viktimat e trafikimit, garanci që i jep një përjasje specifike, të veçantë dhe multidimensionale.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë

veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Vlerësoni se ky dokument përmban të gjitha parashikimet e nevojshme, në mënyrë që të arrihet parandalimi, identifikimi, mbrojtja dhe koordinimi i veprimëve të gjithë aktorëve në luftën kundër trafikimit të personave?
- Vlerësoni se nëpërmjet këtij dokumenti, Qeveria Shqiptare i ofron mbështetje efektive të mbijetuarve nga trafikimi?